



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 865 / prot.
167

Tiranë, më 09.07 2024

V E N D I M

Nr. 18 , datë 09.07 2024

Për

“MIRATIMIN E DOKUMENTIT: “ANALIZË E TREGJEVE ME SHUMICË TË
AKSESIT NË BROADBAND””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Tomi	Frashëri	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
3. Z. Bleron	Dokle	Anëtar
4. Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taci, në mbledhjen e datës 09.07.2024, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Tregjeve dhe Masave Rregullatore, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit – “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks – Dokument Përfundimtar””.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 31 e në vijim i Kreut VI (Rregullimi i Konkurrencës) të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (Ligji nr. 9918/2008);
2. Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);

3. Rregullore Nr.9 "Për Analizën e Tregut", miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
4. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti "Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks – Dokument Përfundimtar";
2. Projekt-Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në cilësinë e organit të vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit nr. 9918/2008, duke synuar promovimin e konkurrencës efektive/efiçente me qëllim sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike.
2. AKEP në cilësinë e Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar kontratën Nr.865/22, datë 10.8.2023, me objekt "Konsulencë për vlerësimin për kryerjen e analizave të tregut Broadband" me operatorin ekonomik fitues, bashkimin e operatorëve Albanian Business Partner sh.p.k dhe Tera Consultants. Kontrata e mësipërme është amenduar me kontratën Nr.865/54 Prot. datë 06.03.2024.
3. Nëpërmjet shërbimit të kësaj kontrate konsulence është synuar përfitimi i një analize të thelluar të tregut broadband, për të gjitha nën-tregjet të cilat ndikojnë në zhvillimin e ofrimit të shërbimit internet nga rrjetet fikse në Shqipëri, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Rregulloren nr.9/2009 për analizën e tregjeve.
4. Gjithashtu, në hartimin e këtij dokumenti janë marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet e tregut celular në momentin e përpunimit të analizës.
5. AKEP në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik.

6. Bazuar në përcaktimet e nenit 110 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe rregulloren nr. 21, datë 7.12.2021 “Për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik”, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara, Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr.1, datë 10.01.2024 miratoi për Këshillim Publik dokumentin: “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks”, periudha e këshillimit publik 11.01.2023 – 11.03.2024.
7. Në përfundim të Këshillimit Publik, në AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara si më poshtë:
- Vodafone Albania sh.a me shkresën LEA/022/J.L.L.R.E.P, datë 11.03.2024;
 - One Albania sh.a me shkresën Nr.111/1 Prot., datë 11.03.2024 (referenca e AKEP Nr.893 prot., datë 11.03.2024);
 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën Nr.2891 Prot., datë 28.03.2024 (referenca e AKEP nr.865/57 Prot., datë 29.03.2024)
 - Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr.62/5 Prot., datë 29.03.2024 (referenca e AKEP nr.1027 Prot., datë 04.04.2024).
8. Në përputhje me termat dhe objektin e kontratës, pas marrjes së komenteve të palëve të interesuara konsulentët kanë hartuar dokumentin përfundimtar “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks” i cili sintetizon edhe komentet e operatorëve dhe rekomandimet e tyre për secilën pikë të trajtuar në dokumentin për këshillim publik.
9. Dokumenti “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks – Dokument Përfundimtar”:
- a. është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik të zhvilluar më 11.01.2023 – 11.03.2024, dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet (Aneks II, i dokumentit) në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - b. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - c. nga pikëpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918/2008 dhe Rregulloren për Analizën e tregut 9/2009;
 - d. nga pikëpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
 - e. ka marrë në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për këto tregje, me synimin përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun broadband internet nga vendndodhje fikse në Republikën e Shqipërisë;

- f. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918/2008, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918/2008.
10. Dokumenti “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks – Dokument Përfundimtar” përmban:
- një përmbledhje e zhvillimeve kryesore në tregun e broadband fiks në Shqipëri që nga vendimi paraardhës i analizës së tregut;
 - përkufizimin e tregjeve përkatëse të analizuara:
 - a. Tregu me shumicë i aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA);
 - b. Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA);
 - c. Tregu me shumicë i aksesit me cilësi të lartë nga vendndodhje fikse (WHQA);
 - analiza e konkurrencës në tregjet përkatëse dhe vlerësimi nëse ka operatorë me fuqi të ndjeshme në treg;
 - masat rregullatore të propozuara për sipërmarrësit e vlerësuar me FNT;
 - modelin benchmark për rregullimin e tregjeve me shumicë të broadband fiks në Rumani, Mal të Zi dhe Francë.
11. Tre tregjet e para të aksesit në Broadband fiks me shumicë, janë pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP me Nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e tregut”, e ndryshuar, gjithashtu edhe pjesë e tregjeve për rregullim sipas rekomandimit të Komisionit Evropian të vitit 2014, dhe për këtë arsye Grupi i Konsulentëve nuk e konsideroi të nevojshme të bëjë një analizë të tre kritereve nëse këto tregje janë tregje përkatës të justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante*.
12. Të tre tregjet sa më sipër janë përkufizuar nga pikëpamja e produktit dhe dimensionit gjeografik, duke u bazuar në zëvendësueshmërinë e produkteve nga ana e kërkesës dhe ofertës. Nga kjo analizë konsulentët arritën në përfundimin se këto tregje kanë dimension kombëtar, bazuar në analizën e konkurrencës dhe dinamikave në këto tregje.
13. Pas vlerësimit të konkurrencës në tregun me pakicë dhe më pas në tregjet përkatëse me shumicë, konsulentët kanë arritur në përfundimin se konkurrenca në tregjet me pakicë është efektive, pavarësisht mos-përdorimit të produkteve nën rregullim aksesit me shumicë të operatorit ‘incumbent’ nga ana e operatorëve të tjerë.
14. Për sa më sipër, propozohet mos-përcaktimi i asnjë sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse dhe heqja e të gjitha detyrimeve rregullatore për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT në secilin nga tregjet më poshtë:
- a. Tregu me shumicë i aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA);
 - b. Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA);
 - c. Tregu me shumicë i aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA);

15. Gjithashtu, në dokumentin e analizës së tregut është analizuar edhe tregu me shumicë i aksesit në infrastrukturën pasive (PIA), treg i cili nuk është pjesë e listës së tregjeve të rregulluara në rregulloren e AKEP nr. 9/2009 e ndryshuar, si rezultat në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9918/2008 dhe rregullores për analizën e tregut, është konsideruar e nevojshme kryerja e analizës duke u bazuar në parashikimet e testit të tre kritereve për të përcaktuar nëse ky treg është i justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante*. Tre kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative paraqiten si vijon:
- Prezenca e barrierave të mëdha dhe jo tranzitore, si barrierat strukturore, ligjore dhe rregullatore për hyrjen në treg;
 - Një strukturë tregu që nuk tenton drejt konkurrencës efektive;
 - Ligji konkurrencës, i vetëm, është i pamjaftueshëm për të adresuar dështimet e tregut.
16. Nga vlerësimi i testit të tre kritereve u arrit në përfundimin se ky treg nuk e kalon kriterin e dytë dhe të tretë të testit për arsye si vijon:
- Kriteri i parë i testit plotësohet, ndër të tjera edhe për arsye të: a) kompleksitetit të procesit të marrjes së lejeve për vendosjen ose shtrirjen e rrjetit backbone, dhe b) rivendosjen nga Gjykata e Lartë (Vendimi Nr. 00-2023-2934) e të drejtave ekskluzive të sipërmarrësin Albanian Telecommunications Union sh.p.k në akset rrugore nacionale të cilat evidentojnë ekzistencën e barrierave jo kalimtare ligjore dhe rregullatore për hyrjen në treg;
 - Kriteri i dytë nuk plotësohet: me gjithë asimetrinë në peshën e tregut për fibrat e errëta midis One Albania dhe ATU, ka elementë që tregojnë ekzistencën e një konkurrence midis të dy operatorëve kryesorë në këtë treg. Ata kanë një mbulim të krahasueshëm gjeografik dhe të dy përballen me kërkesë në rritje për shërbimet e tyre;
 - Kriteri i tretë nuk plotësohet: Për shkak të ekzistencës së konkurrencës ekzistuese ndërmjet sipërmarrësve One Albania dhe ATU dhe trysnisë indirekte konkurruese nga ana e operatorëve të rrjetit si Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), ndërhyrjet *ex-post* të Autoritetit të Konkurrencës apo ndërhyrja e AKEP në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve janë të mjaftueshme për të adresuar në mënyrë të përshtatshme problemet e konkurrencës në tregun në shqyrtim.
17. Tregu me shumicë i aksesit në elementët pasivë të infrastrukturës së rrjeteve fikse është përcaktuar si treg kombëtar që përfshin tubacionet nëntokësore dhe fibrën e errët. Pas kryerjes dhe vlerësimit të testit të 3 kritereve dhe mos-përmbushjes së këtij testi në mënyrë kumulative sipas përcaktimeve rregullatore arrihet në përfundimin se ky treg nuk justifikohet për analizë dhe ndërhyrje rregullatore *ex-ante* dhe si rezultat nuk mund të vijohet me përcaktimin e sipërmarrësve me FNT në këtë treg dhe vendosjes së masave rregullatore *ex-ante*.
18. Pika 3 e nenit 34 të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, përcakton se nëse AKEP-i bazuar në procedurën e analizës së tregut arrin në përfundimin se tregu përkatës ka konkurrencë efektive, pra asnjë sipërmarrës nuk ka fuqi të ndjeshme në treg, në këtë rast ajo nuk vendos

detyrimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përjashtuar ato të përcaktuara në nenin 51 të këtij ligji. Nëse ndaj sipërmarrësve në këtë treg janë vendosur detyrime të veçanta, ato hiqen.

19. Dokumenti “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks – Dokument Përfundimtar” shërben si bazë për heqjen e statusit dhe masave rregullore për sipërmarrësit e shpallur me FNT në tregjet me shumicë të aksesit broadband në rrjetet fikse të vendosura në proceset e analizës pararendëse.

PËR KËTO ARSYE:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin, “Analizë e tregjeve me shumicë të aksesit në Broadband fiks – Dokument Përfundimtar”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Vendimet Nr. 2701, datë 22.12.2016, Nr.2702, datë 22.12.2016, Nr.2703, datë 22.12.2016, Nr.2704, datë 22.12.2016 dhe Nr.13 datë 04.05.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP shfuqizohen.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë brenda afatit 45 (dyzet e pesë) ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
4. Ky Vendim dhe dokumenti i miratuar në pikën 1 të publikohen në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.
5. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullore dhe Grupi i Punës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Tomi Frashëri



Anëtar

Edlira Dvorani

Anëtar

Bleron Dokle

Anëtar

Armer Juka